

PROJEKTSTATUTI I ORGANIZATES MARKSISTE LENINISTE TE KOSOVES

Themelimi dhe qëllimi i OMLK-së

- * OMLK është repart i organizuar revolucionar i popullit shqiptar në Jugosllavi.
- * OMLK u lind, u rrit, po forcohet e po kalitet në luftë me armiqtë e me tradhtarët.
- * OMLK është një bashkim luftarak vullnetar revolucionarësh që shpreh forcën e saj përmes unitetit të plotë të mendimit e të veprimit, që nuk lejon asnjë veprimtari fraksioniste, përçarëse e diversioniste në radhët e saj dhe asnjë lloj devijimi nga vija e saj politike.
- * OMLK përfaqëson dhe mbron interesat e popullit shqiptar në Jugosllavi, udhëheq me LEVIZJEN POPULLORE PER REPUBLIKEN E KOSOVES, me luftën e saj kundër shovinistëve serbomëdhenjë e aleatëve të tyre dhe si qëllim ka konstituimin e Republikës Socialiste të Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave.
- * Me luftën e saj këmbëngulëse për Republikë, OMLK vetvetiu bën pjesë në lëvizjen revolucionare të të gjithë popujve të botës që luftojnë kundër shtypjes kombëtare e padrejtësive sociale.

Hyrje

Statuti i OMLK-së është i nevojshëm për të rregulluar jetën e brendshme të OMLK-së, funksionimin dhe organizimin e saj.

Statuti i OMLK-së nuk guxon të jetë vetëm një grumbull rregullash formale, por një armë e fuqishme ideologjike e organizative në duar të anëtarëve të OMLK-së, që t'i ndihmojë në çelikosjen e disiplinës dhe në edukimin revolucionar të tyre.

KOHEZIONI I OMLK-së, DETYRAT DHE TE DREJTAT E ANETAREVE

1. Anëtar e OMLK-së mund të jetë çdo njeri që pranon e zbaton Programin e Statutit të OMLK-së, që bën pjesë në njërin prej organizatave të saj, që vënë në jetë vendimet e vijën e saj politike dhe që paguan anëtarësinë.
2. Anëtari i OMLK-së ka për detyrë:
 - a). të jetë besnik, i sinqertë dhe kurdoherë i gatshëm në çdo sakrificë për OMLK.
 - b). t'a ruaj e t'a mbrojë me çdo çmim unitetin e OMLK-së, pastërtinë dhe karakterin luftarak e revolucionar të saj,

- c). gjithmonë t'i vëre interesat e OMLK-së e të popullit mbi interesat personale;
- d). ta ketë si detyrë të shenjtë ruajtjen e sekreteve të OMLK-së, duke pasur parasysh se çdo moskujdes në këtë drejtim është në interes të drejtpërdrejtë të armiqve të popullit tonë dhe ngarkon anëtarin me përgjegjësi të rëndë.
- e). të mos gjunjëzohet as në torturat më mizore para armiqve të popullit e OMLK-së, por kurdoherë e kudo ta ruajë të pastër shembëlltyrën e luftëtarit të lirisë.
- ë). të jetë guximtar e luftarak i pamëshirshëm ndaj armiqve të popullit e të OMLK-së, dhe të jetë agjikator, propagandist dhe mbrojtës i flaktë i vijës së saj;
- g). t'a ruaj e ta çelikosë vazhdimisht disiplinën e OMLK-së, që është e detyrueshme për të gjithë anëtarët, pavarësisht nga meritat dhe vendi që zë secili;
- h). të luftojë parreshtur për kalitjen e ndërgjegjes së tij revolucionare dhe të punojë vazhdimisht në ngritjen e vet ideologjike, arsimore e kulturore.
- i). të jetë parimor, i drejtë, i ndershëm, i thjeshtë, me karakter e vullnet të fortë dhe kurdoherë i dashur me popullin dhe i gatshëm t'i shërbej atij;
- j). të jetë nxënës i masave edukator dhe uhdëheqës i tyre;
- k). të jetë kudo shembull i mirësjelljes e moralit revolucionar-komunist, të mos e ndajë kurrë fjalën nga vepra;
- l). të jetë armik i përbetuar i mendjemadhësisë, karrierizmit, arrogancës, servilizimit dhe frymës së komandimit ndaj shokëve;
- ll). të nxisë kudo vetëveprimin dhe të marrë iniciativën;
- m). të praktikojë gjithnjë kritikën e shëndoshë dhe autokritikën e hapur, të jetë i rreptë e i pamëshirshëm ndaj të metave e gabimeve të tij, të cilat të mos ua fsheh shokëve; i tillë të jetë edhe ndaj gabimeve e të metave të të tjerëve, t'i zbulojë ato dhe me shembullin e luftën e tij të drejtë të ndihmojë në ndreqjen e tyre, të jetë i papajtueshëm me mbytësit e kritikës dhe me ata që pengojnë zhvillimin e saj, që e zëvendësojnë atë me fjalë të bujshme e lavdërime;
- n). të luftojë kundër të kënaqurit me pak, kundër vetëkënaqësisë dhe dehjes nga sukseset;
- nj). të jetë luftëtar i papajtueshëm e zgjidhjes së çështjeve në bazë të marëdhënieve miqësore, të farefisit dhe të lokalizimit;
- o). të luftojë vazhdimisht për mirëkuptim, miqësi e bashkëpunim në mes popujve dhe kurdo e kudo të jetë luftëtar i pamëshirshëm kundër çdo shovinizmi dhe kundër çdo përpjekje për të mbjellur urrejtje e përçarje në mes popujve.

3. Anëtari i OMLK-së ka të drejtë

- a). të marrë pjesë lirisht në diskutimin e të gjitha problemeve dhe çështjeve të politikës së OMLK-së;
- b). të zjgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha organet e OMLK-së;
- c). të praktikojë kritikën konstruktive në të gjitha mbledhjet e OMLK-së, pavarësisht se për ke është fjala;
- d). të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet ku vendoset për veprimtarinë, sjelljet dhe përgjegjësinë e tij;
- d). t'u drejtohet kurdoherë lirisht me shkrim për të gjitha çështje, qoftë me propozime, ide, kritika, parashtresa etj., organeve më të larta të OMLK-së

4. Sanksionet

Për neglizhencë, për mosaktivitet, për mosdisiplinë, për keqpërdorim të emrit apo të mjeteve të OMLK-së etj. anëtari mund të dënohet:

- a) me vërejtje me shkrim;
- b) me parapërgjashtim;
- c) me përjashtim;
- ç) me denoncim e demaskim të hapur për veprimtari përçarëse e fraksi-oniste;
- d) Dekonspirimi i qëllimshëm i sekreteve të OMLK-së, veprimtaria përçarëse e diversioniste dhe gjuhëzimi para armiqve dhe tradhtarve e vënia në shërbim të tyre çmohen e dënohen si tradhëti;
- dh) çdo masë ndëshkuese ndaj anëtarit të OMLK-së, bëhet në prezencë të tij, në organizatën të cilës i takon;

Për çdo masë ndëshkuese anëtari ka të drejtë t'i ankohet Komitetit Drejtues të OMLK-së, i cili brenda 30 ditësh duhet ta shqyrtojë ankesën e të ndëshkuarit dhe arsyetimin e organizatës që ka marrë vendimin. Qoftë i reviduar, qoftë i vërtetuar, vendimi vetëm atëhere mund të bëhet i plotfuqishëm.

5. Pranimi në OMLK

Para se të pranohet një anëtar në radhët e OMLK-së, për të merren informata të hollësishme lidhur me të kaluarën e tij si simpatizant e si kandidat për rezultatin e aksioneve apo detyrave që i janë ngarkuar si provë e fundit për ta organizuar.

- a). Anëtarësimi i anëtarit të ri në OMLK bëhet vetëm me pëlqimin dhe dijeninë e përgjegjësit të celulës, i cili paraprakisht për këtë njofton organin në kompetencat e të cilit është celula;
- b). pranimi i anëtarit të ri bëhet në celulë, ku bashkarisht edhe njëherë

shkoqitet mirë e mirë Programi dhe Statuti i OMLK-së dhe ipen sqarime tjera përkatëse lidhur me format dhe metodat e veprimtarisë së celulës.

c). Ndonjë grup apo organizatë revolucionare mund t'i bashkohen OMLK-së vetëm me pëlqimin e Komitetit Drejtues.

ç). Pranimi në OMLK i një grupi apo organizate revolucionare bëhet vetëm pas një analize të thellë të dokumenteve, botimeve dhe veprimtarisë së tij.

d). Me anëtarët e grupit apo të organizatës të posapranuar duhet të punojë për një kohë një instruktor që e dërgon Komiteti Drejtues.

dh). Anëtarët e rinjë të celulës, duke përfshirë edhe ata që i kanë takuar ndonjë grupi apo organizate tjetër, duhet të japin betimin. Betimi bëhet para Flamurit kombëtar (mundësisht edhe para fotografive të heronjëve të popullit tonë). Me atë rast të gjithë të pranishmit ngriten në këmbë, në qëndrim gatitu dhe me grushtin lart dëgjojnë përgjegjësën e celulës duke lexuar këtë betim:

BETOHEM PARA SHOKEVE TE MI NE FLAMURIN KOMBETAR DHE NE FYTYRAT E KUJTIMIN E TE GJITHE ATYRE QE DERDHEN GJAKUN PER LIRINE E ATDHEUT DHE PER ÇESHTJEN E REVOLUCIONIT PROLETAR, SE SI KOMUNIST E PATRIOT DO T'I PERMBAHEM RREPTESISHT PROGRAMIT E STATUTIT TE OMLK-së, SE TERE JETEN TIME DO T'IA KUSHTOJ ÇESHTJES SE POPULLIT DHE NUK DO TE KURSEJE AS PIKEN E FUNDIT TE GJAKUT PER REALIZIMIN E IDEALEVE TE TIJ. ÇDO ZBULIM I SEKRETEVE TE OMLK-së DHE ÇDO DEPONIM PARA ARMIKUT KONSIDEROHET TRADHTI: TRADHTIA PAGUHET ME KOKE. PO QE SE NUK I PERMBAHEM KETIJ BETIMI MOS I SHPETOFSHA DENIMIT TE MERITUAR TE POPULLIT TIM!

Në fund të leximit të gjithë të pranishmit duhet të thërrasin: BETOHEM!

III. Struktura organizative e OMLK-së dhe demokracia e saj e brendshme

1. Parim themelor i ndërtimit organizativ të OMLK-së është centralizmi demokratik, që organet udhëheqëse të OMLK-së të zgjidhen nga poshtë-lart;

a). Për aktivitetin e tyre organet udhëheqëse të OMLK-së japin llogari para organizatave që i kanë zgjedhur;

b). Organet udhëheqëse të OMLK-së duhet të dëgjojnë me vëmendje mendimin e organizatave më të ulëta, të marrin mendimin dhe përvojën e tyre për të përpunuar vijën dhe për të përcaktuar direktivat e OMLK-së;

c). Organet më të ulëta të OMLK-së duhet të japin llogari para organeve më të larta të saj;

- ç). Vendimet e organeve udhëheqëse të OMLK-së janë të obligueshme për organet më të ulëta;
- d). Vendimet merren pas diskutimit të lirë, pas shoshitjes së hollësishme të mendimeve e ideve, dhe kur merret një vendim unanimisht apo me shumicë votash, të gjithë anëtarët e OMLK-së detyrohen ta zbatojnë;
- dh). Diskutimi i lirë dhe i shëndoshë për problemet e politikës së OMLK-së në organizata të ndryshme ose në gjithë OMLK është për çdo anëtar një e drejtë e paprekshme që buron nga vetë demokracia e brendshme e OMLK-së. Por po qe se demokracia e brendshme nuk përcillet me një disiplinë të ndërgjegjshme ajo sajton amullinë, krijon fraksionet, cenon unitetin e OMLK-së;
- e). OMLK në marrjen e vendimeve, në udhëheqje dhe përgjithësisht praktikon parimin e kolegjalitetit, duke kombinuar vazhdimisht punën kolegjiale me përgjegjësinë personale;
- ë). OMLK organizohet në bazë të vendbanimit, vendqëndrimit dhe vendprodhimit;
- f). Në bazë të numrit të celulave dhe vendit ku militojnë udhëheq Komiteti Lokal apo Komiteti i Rrethit;
- g). Të gjitha organizatat e Lëvizjes problemet lokale i zgjidhin vetë, por në përputhje të ngushtë me vijën politike të OMLK-së.

IV Organet e OMLK-së

- 1). Organi më i lartë i OMLK-së është Konferenca e OMLK-së . Ajo thirret nga Komiteti Drejtues i OMLK-së jo më shpesh se në ^{dy (2)} ~~gjatë~~ vite ~~me~~. Komiteti Drejtues ka për detyrë të thërras konferencën nëqoftë se kjo kërkohet nga komitetet lokale ose nga grupet dhe celulat e OMLK-së, që kanë patur së bashku një të tretën e votave në konferencën e fundit. Konferenca quhet e vlefshme nëqoftë se në të është përfaqësuar më shumë se një e dyta e të gjitha rretheve të OMLK-së.
- 3). Të drejtën e përfaqësimit në konferencë e kanë :Komiteti Drejtues, Redaksia, të gjitha komitetet lokale dhe të rretheve, grupet e veçanta të OMLK-së. Në konferencë marrin pjesë nga një ose dy përfaqësues të organeve të cekura dhe kanë nga dy vota.
- 4). Konferenca e OMLK-së e cakton Komitetin Drejtues dhe Redaksinë.
- 5). Komiteti Drejtues bashkon dhe drejton gjithë veprimtarinë praktike të OMLK-së si dhe mban fondin qendror dhe teknikën qendrore.
- 7). Këshilli i OMLK-së caktohet nga konferenca midis Redaksisë dhe Komitetit Drejtues dhe përbëhet prej tre vetave. Këshilli zgjidh grindjet ose mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Redaksisë dhe Komitetit Drejtues. Këshilli i OMLK-së e përtrin Komitetin Drejtues me rastin e një dështimi të plotë të tij.
- 8). Komiteti lokal apo i rrethit drejton punët që i përkasin zonës së tij përkatëse duke iu bindur vendimeve të Komitetit Drejtues dhe Redaksisë.

9). Grupet e OMLK-së janë grupe speciale për veprimtari të ndryshme revolucionare, dhe janë të lidhura drejtëpërdrejt me Komitetin Drejtues.

10). **Celula** - bërthama e OMLK-së

- a) Celula është themeli i OMLK-së, lidhja e saj e drejtëpërdrejtë me popullin;
- b) Celula është burim i pashterrshëm i OMLK-së që ia shton e ia kalit luftëtarët, që i sjellë asaj të freskët përvojën, mendimin dhe kërkesat e popullit;
- c) me celulën udhëheq përgjegjësi i saj, i cili i raporton rregullisht komitetit përkatës për tërë veprimtarinë e celulës:

Detyrat e Celulës janë:

- * të bëjë punë të gjallë politike, ideologjike, organizative e propagandistike;
- * të zbatojë vijën dhe direktivat e OMLK-së;
- * të dëgjojë me vëmendje mendimin dhe kërkesat e masave, t'i sqarojë, t'i mobilizojë e t'i udhëheq ato kundër të gjitha aksioneve të armiqëve, dhe të përpiqet për vënien e tyre në jetë;
- * të shpërndajë shtypin e LPRK-së, ta jap mendimin e vet dhe të mbledhë informata dhe të shkruajë korrespondenca për te;
- * të organizojë edukimin politik, ideologjik, arsimor, kulturor, profesional të anëtarëve e të simpatizantëve të OMLK-së. Kështu celula duhet të jetë çerdhe e vërtetë revolucionarësh, shkollë e madhe kalitjeje dhe edukimi komunist;
- * t'i edukojë anëtarët e OMLK-së me një vigjilencë të përhershme revolucionare dhe t'i përgatisë ato që në çfarëdo rrethanash që të krijohen të jenë të aftë t'i mobilizojnë, t'i organizojnë dhe t'i udhëheqin masat në luftë kundër armiqëve.
- * të zhvillojë kritikën dhe autokritikën e sinqertë, është detyrë e çdo anëtari; të kritikojë dobësitë dhe gabimet që vërehen në veprimtarinë e celulës në përgjithësi dhe të çdo shoku në veçanti. Të ngurrohet t'i thuhet tjetrit të metat nuk është gjë tjetër veçse pasqyrim i raporteve false të politikës borgjeze që bën të jesh hipokrit, që bën të krijohen kritikrat dhe armiqësitë. Ngurrimi i të kritikuarit të të metave dhe gabimeve, gjoja për të ruajtur unitetin e Celulës-OMLK-së, është pasqyrim i mosshikimit të drejtë të kritikës dhe autokritikës. Kritika dhe autokritika komuniste nuk dobëson, por forcon akoma më shumë unitetin dhe dashurinë mes shokëve si dhe autoritetin e anëtarëve.

- * t'i caktojë çdonjërit prej anëtarëve detyrën përkatëse, në të cilën ai duhet të perfeksionohet e specializohet vazhdimisht;
- * të ndihmojë komitetin lokal apo të rrethit në punën e tyre, duke rritur vetëveprimin e iniciativën në zbatimin e vijës dhe vendimeve të OMLK-së.
- * ta ruajë konstant karakterin luftarak të OMLK-së, të krijojë brenda radhëve unitetin e plotë të mendimit dhe të veprimit dhe një atmosferë të përhershme sinqeriteti, vëllazërie e entuziazmi revolucionar;
- * të organizojë e të udhëheqë edukimin revolucionar të punëtorëve dhe sidomos brezit të ri duke i mbrujtur me traditat patriotike e revolucionare të popullit, me ndjenjën e vetëmohimit ndaj çështjes së popullit, me vemndosmërinë e shpirtin e sakrificës për të përballuar çdo pengesë e vështirësi, me dashurinë për punën dhe me urrejtjen, papajtushmërinë e me ndjenjën e luftës së ashpër kundër armiqve e tradhtarëve, kundër çdo gjëje të keqe, prapanike, konservatore e reaksionare.

V. Mjetet financiare të OMLK-së

OMLK financohet nga kuotizacioni i anëtarësisë dhe nga ndihmat që jep populli.